

INTERVISTË ME MARTE PREKPALAJ

Has, Prizren | Data: 5 qershor 2013

Kohëzgjatja: 105 minuta

Të pranishme

1. Marta Prekpalaj (Sagovornica)
2. Anita Prapashtica (Intervistuesja)
3. Nicole Fransworth (Intervistuesja)
4. Jung Chao, Donjetë Berisha (kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi joverbal: ()
komunikim emocional
{ } e intervistuar shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:
[] shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

Fëmijëria

Anita Prapashtica: Më tregoni për fëmijërinë tuaj.

Marta Prekpalaj: Po, unë së pari të them se jam e lindur me 10 maj 1967. Jam fëmija i dytë në familje. Fëmija i parë ka qenë vëllai i madh, Luzi. Unë e dyta vajzë dhe pastaj kam pas dhe kam edhe dy vëllezër të tjerë, do të thotë, kam tre vëllezër dhe vetë. Më kanë tregu se në lindjen time ka qenë atëherë mentaliteti mos me u gëzu për vajza, mirëpo për mu janë gëzu shumë, veçanërisht, është gëzu shumë babai im, tashmë i ndjeri. I cili edhe pastaj ka qenë personi i vetëm dhe njeriu të cilin me mall e kam dashur shumë, dhe kam qenë shumë e lidhur me dashtë, personi i vetëm i jemi gjatë jetës dhe që mo nuk e kam. Kemi qenë katër fëmijë këtu në fshatin Breg Drini të Hasit¹, të lindur natyrisht në atë kohë, nuk kanë qenë kushtet aq sa të mira, po shumë me rëndësi se ka qenë një ngrohje familjare. Familja ka qenë, kemi qenë një familje me babën, nanën, vëllezërit dhe gjyshen apo loken si i kam than unë. Lokja, që edhe ka qenë një person i cili po thuajse ma shumë kam nejtë me atë, pasi nana kishte vëllaun edhe vëllaun tjetër mbas meje dhe kështu që unë në një farë mënyre u lidha me të. Ajo ka qenë një grua, një loke shumë e mirë, shumë e zoja që ka pasë një jetë shumë të vështirë. E natyrisht jam rritë me ato tregimet e saj, por edhe me mësimet e saj, sepse ajo ka qenë gjyshja, lokja, nana e babës. Ka qenë një grua, në atë kohë e ve, që ka rritë fëmijët jetima sikur na kemi rastin tash mas luftës, dhe natyrisht që kam përfitu shumë nga ajo, sidomos në edukim.

Po ashtu, edhe gjyshja tjetër nga nana, po ashtu edhe ajo ka qenë një loke, një grua shumë e mirë edhe ajo ka qenë e dashur për mua, më ka dashtë shumë dhe më ka mësu gjëra të mira, t'rrëndësishme sidomos në atë se si të ndihmojmë njerëzit. Fëmijëria këtu në fshat ka qenë e mirë. Ne kemi pas afër lumin dhe momentet më të bukura të jetës dhe ato si fëmijë, lojnat më të bukura i kemi bo gjatë stinës së verës në lum, në Drinin e Bardhë që kemi, dhe janë natyrisht ato periudhat domethanë që nuk kemi pas as brenga as kurrgjo. Veç kemi luft' në atë kohën gjatë verës edhe natyrisht kur kemi fillu me u rritë i kemi ndihmu edhe familjës. Janë ato punët e fshatit të dikurshme kur ne, për shembull, mbaj mend kohën kur nana ka korr grurin me dorë edhe lokja e ne kemi shku e kemi çu ujë të freskët të fshatit. Ajo ka qenë për ne një kënaqësi, një ndjenjë e mirë që çuam ujë dhe po kryejmë një punë për atë kohë.

E kështu që, pastaj gradualisht në moshën shtatë vjeçare kemi shku në shkollë fillore. Pak ka qenë vështirë për ne, se e kemi pas shumë larg shkollën. Domethanë prej klasës së parë ne kemi shku në një fshat tjetër në shkollë, fshati Zymë atje. Kemi kalu në një drejtim kater kilometra dhe në drejtimin tjetër, rreth tetë kilometra në ditë i kemi bo nëpër mal. Mirëpo dëshira, vullneti për shkollë ka qenë shumë i madh atëherë, jo vetëm të unë por edhe të krejt shokët edhe shoqet që kemi qenë gjenerata jonë. Kemi mësu shumë. Ka qenë pastaj edhe pjesa e bukur e jetës,

¹Regjion rural, malor e tradicional në pjesën verilindore të Kosovës, në kufi me Shqipërinë.

mësuesja. Kam pas fatin ta kem mësuese në shkollë kater vjeçare fillore, edhe ka qenë një moment po ashtu shumë i rëndësishëm që ndoshta ka ndiku që unë në të ardhmën ta kem edhe profesionin e mësueses se ajo ka qenë idolli. Po ashtu edhe profesionin tim. Fëmijëria nuk ka qenë edhe keq po edhe mirë jo, por në përgjithësi mirë, por për mu prapë është me rëndësi të them që kam pasë atë dashurinë familjare. Kam pas prindërit edhe gjyshen, të dyja gjyshet, të cilat vazhdimisht me ato kam qenë bashkë shumë kohë, edhe me dy vëllezërit më të vegjël. Është dashtë edhe ata me i kqyrë. Edhe kështu qëmirë ka qenë, fëmijëri e mirë.

Pastaj, në momente të jetës fëminore ka shumë edhe të mira edhe të hidhura. Prej momenteve të tilla ka qenë momenti kur është nda nga jeta mësuesja. Ajo ka qenë për mu një moment i vështirë, në klasën e tretë të shkollës fillore atëherë. Edhe patë vdekur, edhe ka qenë një moment i vështirë. Momete të tjerë kemi pas si çdo fëmi, vështirësi, probleme të ndryshme. Edhe jemi lëndu, edhe kemi bo ndonjë problem, po jo shumë të madh sa për me u kujtu. Menjëherë, mbasi isha edhe vajzë e vetme këtu në shtëpi edhe ka qenë pak një orientim i imi me i ndihmu shumë nanës me punët e shpisë, po krahas nënës, natyrisht edhe babës, domethanë, vazhdimisht kemi qenë pak të preokupum se fshati ka shumë punë, mirëpo vazhdimisht tërë kohën, kam qenë shumë e lidhur dhe e pasionume mas librave.

Kemi pas fatin që atje në shkollë në Zymë, në atë kohë të kemi bibliotekë dhe aty kam fillu me lexu librat dhe prej aty ka lind ajo dashuria dhe dëshira për shkollë. Po e them këtë për shkollë, sepse pastaj janë momente kur unë masi kam maru shkollën fillore, kanë fillu disa pengesa të rrethit të mentalitetit për me u shkollu vajzat kur dihet se dikur ktu vajzat nuk janë shkollu. Me të mbaru shkollën fillore, kam qenë për dy vite të shkollës së mesme atje në Zymë. Ka qenë shumë problem për të vazhdu, po ma vonë për të vazhdu shkollën e mesme ishte problem. Ishte rrethi që thoshte nuk ban me shku në shkollë, se çikat duhet me nejt në shpi, me u feju, me ba çejzna e ato. Unë isha këmbëngulëse, edhe po ashtu me rëndësi ma shumë në këtë histori të jetës time për shkollim më ka përkrahë edhe baba, i ndjeri, i cili ka pas qef shumë shkollën. Nana jo që nuk donte për me shku në shkollë, po të nana ndikonte ma shumë rrethi dhe i thonin së s'duhet të iki veç një vajzë, edhe se me shku ajo në shkollë nuk ndihet çka bohet, çka ndodh. Prej krejt atij rrethit ku kam qenë unë, prej gjeneratës time, vetëm tri vajza e kemi vazhdu shkollën. Për qata ka qenë kohë atëherë që vështirë me bind rrethin për me shku po me këmbënguljen time dhe me përkrahjen e babës, pastaj edhe vëllaut të madh, edhe pak se me vonesë unë kam arritë me e vazhdu shkollën e mesme.

Nga jeta fëminore kisha me i tregu dy storie të shkurtra, një të cilën unë nuk e mbaj mend, por më kanë tregu, është që më kanë pas vënë jetën shumë në rrezik. Njëherë kam qenë në moshën tre mujore si bebe dhe nana ka shku të axha e babës në dasëm, dhe më kanë lanë mu si bebe të mbështjellur me pelena atëherë të bardha në dhomën e nuses dhe çfarë ka ndodh kur kanë sjellë rrobat e krejt çejzit të asaj nuses, mu më kanë mbulu krejt me to, dhe ka qenë një moment shumë i vështirë në atë kohë se nusja sa ka ardhë ka pa që diçka s'o në rregull, aty diçka është ni, por në atë kohë ka qenë drejtë mos me fol nusja dhe një moment shumë i ndjeshëm, por momenti kur e ka pa nusja që aty vërtetë është diçka, është diçka gjallë aty, është shumë rrezik, ajo ka fol, e kemi zanë aty një bebe dhe pastaj kur më kanë çel gati e nxime, ma kanë shpëtë jetën e m'a kanë kthi jetën.

Dhe po ashtu është një moment shumë i randsishëm në klasën e dytë të shkollës fillore, kemi qenë si fëmijë dhe kanë qenë ato paret atëhershëm, dinari. Ka qenë një pësëdinarsh i madh edhe lokja, e ndjera, thotë që meri këto pare edhe me ble disa gjëra në shitore atje kur shkoj në shkollë. Edhe unë t'u u sjellë rreth sofrës i kam marrë parën, edhe për mos me e marr ky vëllau i

vogël, t'u menu se ai po i shtin në gojë, edhe unë kam fsheh parën në gojë. Në momentin kur janë çu me çu sofrën prej bukës, kam harru dhe parja m'ka shku në fyt edhe ka qenë problem i madh deri kur më kanë qu të mjeku, deri e kanë largu ata. Domethanë kam dy momente nërmen të jetës feminare kur ka qenë jeta në rrezik, po ja që jam. Herën e parë grua e djalit të axhës së babës më ka shpëtuar, e nusja. Herën e dytë grua e axhës më ka ndihmu, edhe më kanë shpëtuar, prej thuajse, prej vdekjes së sigurtë. Domethanë, kto si fëmijë dhe ka edhe momente, edhe moment i vështirë ka qenë kur është nda nga jeta nana e babës, lokja. Është personi që kam dashtë shumë, që kam qenë shumë e lidhur më të, shumë. Ai ka qenë moment i vështirë. Këto kisha me i nda për këto momente të jetës feminare që kanë qenë të rëndësishme.

Jeta Profesionale

Anita Prapashtica: Na tregoni për karrierën tuaj profesionale.

Marta Prekpalaj: Unë si fëmijë, dëshira e madhe ka qenë thashë, dëshira dhe inspirimi ka qenë për t'u bërë mësuese. Por, më të mbaru dy vite të shkollës së mesme në Zymë dhe për të vazhdu në qytet të Prizrenit, edhe pse thashë me shumë vështirësi arrita dhe unë me i bind dhe me vazhdu me u regjistru. Ishte në atë kohë nevojë këtu në rajonin tonë shumë për motra medicinale. Në njëfarë mënyre unë vendosa, se edhe kisha një shoqe këtu, me shku me kry shkollën e mesme të mjekësisë, ngaqë isha nxënëse e shkëlqyeshme dhe i plotësoja kushtet. Atëherë mbarova shkollën e mesme të mjekësisë në Prizren, edhe natyrisht me këtë mbarim të shkollës së mesme, qysh në vitin e parë të shkollës fillova me i ndihmu njerëzve, sepse këtu njerëzit udhëtonin për një injeksion me kilometra. Më të përfundu praktikën e vitit të parë, u angazhova dhe prej atyht fillova të lidhem edhe me njerëzit e rrethit ktu për të i'u ndihmu me ato mundësi sa kisha me dhënë ndihmë të parë, apo një injeksion, apo ndonjë ilaç grave, fëmijëve sipas nevojës.

Domethënë, i bje në vitin 1986 kur kam fillu, kam përfundu shkollën edhe t'u i ndihmu njerëzve, kadalëdalë. Me të përfundu shkollën e mjekësisë, dëshira që ka qenë, andrra ka qenë për t'u bërë mësuese... Vendosi dhe u regjistrova në shkollën e lartë për mësuese në Gjakovë, shkolla e lartë pedagogjike, drejtimi biologjikimi. Dhe natyrisht në vitet 198819891990 kam përfundu, mënjëherë kam diplomu dhe t'u e dit se rajoni i Hasit është një rajon i cili kishte nevojë për shumë kuadro, për gjitha, jo vetëm për mjekësi që thashë shkollat e mesme, por kishte nevojë edhe për mësime dhënë. Atëherë m'u dha menjëherë mundësia me u punësu, menjëherë sa kam diplomu në vitin 1990, dhe jam punësu arsimtare në shkollën e Kushninit të Hasit. Por, viti 19891990 ishte koha kur në Kosovë veç fillun lëvizjet. Fillun demonstratat në atë kohë për të përkrahë, rezistenca kundër shtypjes së Millosheviçit. Por, në vitin 1989 ishte një moment, një ngjarje shumë e rëndësishme për mu, ku në fshatin Rumajë të Hasit erdh dhe u themelu dega e Shoqatës për Zhdukjen e Analfabetizmit Motrat Qiriazit. Atë kohë, kjo shoqatë ishte e organizuar në tërë Kosovën, dhe unë isha në diplomim e sipër dhe kur më ftun që të përfaqësoj fshatin tim Breg Drinin në atë tubim të madh që u mbajt në fshatin Rumajë të Hasit, në atë kohë mbaj mend mirë ishte një numër shumë i madh i njerëzve. Dhe ky që aktiviteti i parë aty dhe mu më caktun që të merrem me fshatin tim dhe secili, edhe pse ishte numri i pakët i vajzave që ishin në atë. Mëgjithatë, detyrat ishin të mëdhaja dhe në atë takim të madh të shoqatës Motrat Qiriazit, natyrisht atëherë kanë qenë aktiviste të shumta anembanë Kosovës. Ka qenë Safete Rogova, që masanej ma vonë u desh të vazhdojmë dhe të punojmë, por aty ka qenë takimi i parë.

Edhe unë me të mbaru shkollën edhe gjatë shkollimit i kisha vënë detyrë vetit që mbasi vetë kisha shumë vështirësi dhe e shihja që shumë vajza të tjera kanë vështirësi, veç i kisha vënë detyrë vetit që duhet t'i ndihmoj disi. Mirëpo, nuk kam ditë atëherë më shumë por në momentin e parë të ardhjes së kësaj shoqatë, që është shoqata e parë që u formu në Kosovë, ndër të parat në këtë drejtim. Atëherë, vërtetë e ndjeva veten mirë shumë dhe m'u dha mundësia me fillu drejtpërdrejtë aktivitetin tamam të mirëfilltë. Dhe kështu që në atë kohë me të gjithë aktivistet e Hasit, e fshatrave të Hasit, filluam aksionin e madh për zhdukjen e analfabetizmit. Domethanë, regjistruam, gjetëm të gjitha ato gra apo vajza që kishin ngelë pa shkrim lexim, edhe pse nuk kishte edhe shumë, por megjithatë, ky ishte pra aktiviteti i parë që kemi bo, edhe kam fillu të angazhohem. Ndërkohë e thashë, edhe u punësova si arsimtare dhe kështu filluan aktivitetet e shumta në këtë rajon të Hasit. Krahas shoqatës Motrat Qiriazhi në atë kohë ishte edhe Forumi i Gruas që ka qenë një aktivitet që kemi ndihmu të gjithë dhe unë kam qenë aktiviste. Unë e kam mbulu vazhdimisht edhe në sektorin e shëndetsisë edhe të arsimit, sepse në këtë kohë filloi edhe arsimi i pavarur në Kosovë dhe shkollat punojshin në mënyrë të pavarur me planprogramet tona, edhe fillun organizimet e para të ndryshme në rajonin e Hasit. Deri në vitin 1994 kemi punu në disa aksione të ndryshme, kurse të ndihmës së parë.

Po në fund të vitit 1994, krahas kësaj unë isha edhe arsimtare natyrisht në punë, filloi puna ma e madhe sepse u riorganizu shoqata Motrat Qiriazhi. Dhe, me këtë riorganizim, edhe me ardhjen edhe të Igballë Rogovës nga Shqipëria, e boni riorganizimin dhe u përqendru dhe orientu që të punojmë në rajonin e Hasit. Unë veç pak kisha lidhje me Safeten, me këshillin organizativ të fshatit në fillim dhe u njoftum dhe organizum, dhe fillim të themi aktivitetet të shumta të njëpasnjëshme. Fillimisht, me shoqatën Motrat Qiriazhi kemi fillu takimet me gra. Kanë qenë takime të lira. I kemi tubu gratë, kemi bisedu me to dhe gjithmonë bashkë kemi marrë ato nevojat apo kërkesat që i kanë gratë.

Problemi kryesor që është paraqit në tubime ka qenë mungesa e shkollimit të vajzave. Edhe ne tash kemi fillu aktivitetet e shumta. Krahas asaj për t'u marrë e me punu me njerëzit, jo vetëm me gratë, edhe me burrat kadalëdalë për m'i bind, për m'i çu vajzat në shkollë. Por, nuk kemi punu veç për me i çu vajzat në shkollë, ne kemi fillu aktivitetin edhe me ato gra me punu diçka. Në atë kohë, në vitin 1995, veç kemi fillu t'i organizojmë kurset e shumta këtu në Has. Kemi fillu me kursin e rrobaqepsisë; ka pas edhe kurse me aktiviste, trajnimet që janë majtë me aktivistet e ndryshme që ka sjellë shoqata, Igo. Pastaj, ka qenë edhe një aktiviste, ka qenë krahë për krahë me ne, Racheli. Kemi realizu me të edhe kurse të gjuhës angleze, që për atë kohë, për këtu në këtë rajon, ndoshta edhe në krejt Kosovën nuk ka pas. Pastaj kemi fillu edhe me kurset e kompjuterave. Po ashtu, ndërkohë, kemi përkrahë dhe jemi angazhu, edhe kemi marrë iniciativa me komunitetin për m'u hapë shkollat e mesme. Aksioni i parë dhe planprojekti i parë që është bo në Has ka qenë hapja e shkollës së mesme në Gjonaj të Hasit, ku edhe ne si shoqatë pastaj kemi pas edhe qendrën tonë, qendrën e gruas Motrat Qiriazhi në Gjonaj. Kemi fillu me komunitetin, me aktivista bashkë tu punu dhe kemi arrit që jo vetëm ta hapim përmes Ministrisë së Arsimit shkollën e mesme, por njerëzit kanë grumbullu mjete financiare dhe kanë ndërtu objektin. Tu e ditë se njerëzit Hasjanë kanë qenë njerëz që kanë punu si bukëpjekës e kanë punu jashtë Kosovës shumë, atëherë aktivistët, të gjithë bashkë ne kemi organizu edhe aksionin e madh me ndërtu objektin në Gjonaj, që për atë kohë ka qenë diçka e pamundur në atë periudhë të viteve 1990, në ato rrethana me u hap shkollë. Pastaj, duke qenë se rajoni ishte shumë i gjerë, ne biseduam bashkë me aktivistët e shoqatës, edhe një shkollë tjetër të mesme ta hapim në Romajë, një paralele e shkollës së mesme, por kësaj rradhe të drejtimin të mjekësisë. Kjo ka qenë një projekt po ashtu shumë i madh, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, shoqatës Motrat Qiriazhi dhe

komuniteti. Ndërkohë, kemi bashkëpunu prapë dhe kemi arrit me e realizu edhe një projekt tjetër me hap ambullantë të Nënës Terezë, natyrisht bashkë me shoqatën Nëna Terezë. Por krejt organizimin teknik e mjetet, i kemi siguru ne si shoqata Motrat Qiriaz, natyrisht me njerëzit. Iniciativa ka qenë e jona bashkë krejt. Kur them këtu kuptohet kemi qenë grup i madh, nuk kemi qenë vetëm, grupi i vajzave që punonin bashkë në shoqatën Motrat Qiriaz.

Ndërkohë, është shumë e rëndësishme në vitin 1995 krahas shumë aktiviteteve që bënim, është një ngjarje, një moment i rëndësishëm për mu... kur unë për herë të parë në rajonin e Hasit apo ndoshta edhe në Komunën e Prizrenit, kam konkurru për një vend të punës të rëndësishëm si drejtoreshë shkolle dhe i'a kam arritë qëllimit (buzëqeshë). Ka qenë një përkrahje dhe një dhënie e idesë nga kolegët dhe shoqet e shoqatës, nga Safetja. Ajo ishte këmbëngulëse, lgballja, të gjitha, "Ti mundesh me u bo drejtoreshë." Për mu në fillim ka qenë e pamundur. Thosha "çysh me u ba unë drejtoreshë shkolle?", por natyrisht ka qenë një barrë, një ngarkesë, por ka qenë mesazh i fortë për komunitetin, për rrethin që edhe një femër mundet me udhëheq një shkollë. Kam qenë e vetmja në rajon këtu po edhe në Prizren në fillim, pastaj janë edhe dy kolege. Edhe kjo ka qenë një sfidë për mu, një kohë e vështirë në jetë sepse kisha rreth 600 nxënës, rreth 30 punëtorë, dmth ishte një shkollë në ato kushte pa mjete financiare, pa buxhet, tu punu me fshatarët me i siguru mjetet të gjitha. Dihet siç ka qenë arsimit në Kosovë. Gjatë aktivitetit tonë të shumtë me shoqatën, ka qenë po ashtu krahas kurseve, organizimeve kemi bo edhe veç vajzat tash fillun më shku në shkollë në Gjonaj. Në Romajë, numri filloi me u rritë, por shoqata kishte bashkëpunim të mirë në atë kohë më të gjitha shoqatat e tjera jashtë Kosovës. Ka qenë një bashkëpunim i mirë me gratë në ish-Jugosllavi, që lëvizja e grave në ishJugosllavi, kanë qenë Gratë në të Zeza, shumë të tjera, qendra e grave në Novi Sad. Natyrisht, shoqata Motrat Qiriaz fituam një përkrahje shumë të madhe dhe ne arritëm pastaj me realizu edhe projekte të tjera. Krahas këtyre ne kemi fillu edhe hapjen e bibliotekave dhe kjo ka qenë një moment shumë i rëndësishëm për komunitetin tonë, iniciativa e shoqatës kur kemi hap bibliotekat në rajonin e Hasit.

Nuk ka qenë lehtë por bashkë kemi arritë që t'i pajisim disa biblioteka si në Gjonaj, Kushnin, në Mazrek të Hasit, janë këto bibliotekat që i kemi hap edhe në Romajë të Hasit, edhe në Lugishtë, para luftës, që ma vonë disa nga ato edhe janë djegë. Por, e gjithë puna e jonë ka qenë e lidhur drejtpërdrejtë me edukim, arsimim, emancipim në përgjithësi të këtij rajoni rural. Menjëherë, janë pa rezultatet e para në atë kohë. Janë matë rezultatet, sukseset tona që kemi bo në këtë komunitet. Numër një ka qenë vazhdimi i shkollimit të vajzave, që më herët ka qenë diçka e pamundur, e paarrtshme. Po ashtu ka pasë shumë vështirësi këtu në rajon me punu se ka qenë zonë kufitare, Hasi dhe kohë pas kohe kemi pasë probleme. Unë kam pas edhe vështirësi me policinë, kam qenë në pyetje disa herë për këtë aktivitet, se pse po merrem me aktivitete e kam qenë e marrë në pyetje nga sistemi atëherë policor, inspektorati. Unë kam pas në vitin 1976², kam pas nijet edhe me përfaqësu KosovëShqipëri. Kam pas një konferencë të rajonit të Ballkanit, natyrisht në emër të shoqatës Motrat Qiriaz po edhe kjo ka pasë pasoja, pse kemi shku në Shqipëri e kshu. Pastaj, kam pas probleme se jam drejtoreshë shkolle, më çfarë planprograme punonim edhe aktivitete që i bënim me shoqatë në atë kohë, vinin edhe kolege që vinin nga jashtë, nga Amerika, nga Anglia, nga vende të ndryshme të Evropës, edhe ajo ka qenë problem pse vijnë këto. Po ne natyrisht kemi pas aktivitetin tonë për edukim. Nuk kemi pas të bëjmë me politikë, mirëpo ishte problem në atë kohë. Thujse çdo gjë pushteti dëshironte ta përcjellte e ta dirigjonte se çka po ndodh, çka po bohet. Po sigurisht, ajo ka qenë një organizim i madh i këtyre aktiviteteve. Ne kemi organizu edhe gara këtu në Has. Kemi pasë edhe gazetën tonë *Të Jesh Grua*,

²Kjo ka ndodhë në 1996.

pastaj ka pasë komuniteti gazetën *Etja*, domethanë shoqata, aktivistet kemi qenë të kyçuna në të gjitha fushat, edhe për këtë edhe ishim pengesë për pushtetin, “Pse ju merreni me gjithë këto aktivitete dhe arrini gjitha këto qëllimet, gjithë këto angazhime.” (Buzëqeshë)

Është shumë interesant, aktiviteti i parë që kemi fillu me gratë në rajonin e Hasit, nuk kemi has shumë vështirësi tek burrat. Burrat hajsanë këtu kanë pranë këtë. Ndoshta njëherë në fillim e kanë shiku me një sy disa, s'po them që s'ka pasë. Mirëpo, ne kemi qenë vazhdimisht në lëvizje dhe kemi punu me komunitetin, për shembull ne vendtakimet i kemi mbajtë më shumë në shkollë. Kemi punu me drejtorat e shkollave, me arsimtarët, me udhëheqësat e fshatit. Edhe ata i kanë mirëpritë, sidomos aktivistet. Janë kon njerëzit diqysh të gatshëm për ndryshime, vetëm dikush me marrë iniciativë, me u organizu. Më kujtohet sa herë na kanë transportu, se na kemi ecë në komë [këmbë]. I gjithë ky aktivitet që asht ba, ne kemi udhëtu si aktivistë me çka kemi mujtë, me kerr kali, me traktor. Më kujtohet një moment kur kemi shku më Safeten në fshatin më të largët të Hasit, Guruzhupit, me traktor, edhe më thoshte Safetja “A mbririmë?” Unë i thosha “Edhe pak, edhe pak!” Ajo ishte shumë larg, mirëpo ishte me të vërtetë një kënaqësi atje kur shkojshe edhe të pritshin një numër i madh i grave.

Ishin momente shumë... Kemi kalu periudha të ndryshme dhe njerëzit kur na shihshin, se ne nuk shkonim vetëm nëpër mbledhje me gra, ne shkojshim edhe në darsëm, edhe në ndejë, edhe çdo organizim që kishin banorët këtu, edhe ishim çdo moment me ta. Dhe kështu kur ishim ne me ta, ne nuk shkonim në atë mënyrën më të thënë që kemi ardhë me ju msu. Po jo, “na jemi me ju dhe na kemi ardhë vetëm me ju dëgju çka po thoni ju, qysh do i'a bajmë.” Se Safetja dhe Igballja kanë qenë dy aktiviste me shumë përvojë që kanë ardhë dhe kanë ditë një mënyrë, e kanë gjetë një çelës. Se ndoshta të gjithë tjerët thojnë se në shumë vende, në vise të tjera kanë pasë probleme me burra, ne nuk kemi pasë. Nuk ka qenë problem me i lanë me ardhë nëpër takime, ose në angazhime, ose në aktivitete, ose në çfarëdo kursi. Bile, bile ka pasë kanihere edhe shumë kërkesa që ishte edhe e vështirë me i mbulu të gjitha, sepse ishte rajoni i madh. Hasi ka shumë fshatra, hapësirë shumë e madhe.

Mirëpo, shumë me rëndësi që e përmënda udhëtimi jonë që e kemi bo. Ne si aktiviste, kudo që kemi qenë, në traktor, në autobus, kemi bo aktivitet. Nëse jemi taku në autobus me një prind apo me një gru, kemi bisedu vazhdimisht, kemi fol për çështje të emancipimit, edhe ka pasë raste kur o bindë edhe një prind aty në autobus. Kemi pas gjatë punës sonë për të bindë prindërit për të shku në shkollë. Janë nga këto momentete që duhet më i kujtu. Kemi pas një rast në Gjonaj të Hasit, me Safeten edhe me Igon, me ditë t'ëtra e netë kemi nejtë në atë familje, sa e bindshim njonin vëlla, thojke “Po” kur të nesërmen thoshin “jo” për me e çu motrën në shkollë. Ka qenë një rast në Gjonaj.

Shumë mirë më kujtohet, me qëndrimin tonë disa ditor aty, me shoqërimin tonë në familje, edhe me Igon edhe me Safeten, mas disa ditësh arritëm, se ishte edhe ajo një rast shumë specifik. Ishte një vajzë, një motër që kishte shtatë vëllezër. Ata nuk donin me e lanë me shku në shkollë edhe na qëndruam një kohë aty, t'u bisedu, t'u i marrë shembuj tjerë, t'u i tregu se asht mirë me shku në shkollë. Për shembull, ne kemi pas një grup me aktiviste të tjera që kishim kry shkollën dhe merreshin shembuj, edhe ka qenë një moment shumë i rëndësishëm mas disa ditësh kemi arritë ma në fund me bind atë. Se ka pas shumë prej atyne që nuk janë bindë, kështu na kanë pritë mirë, mirëpo kur ka ardhë puna te ajo, ka pas nganjëherë vështirësi.

Ka pas raste kur edhe vetë kanë ardhë ata prindërit, na kanë prur vajzën. Kanë dëgju për ne që punojmë tha “qe vajzën çoje në shkollë.” Më kujtohet një rast, në Kushnin po ashtu. Unë isha në shkollë, po natyrisht t'u punu, edhe kur vjen baba me një vajzë përdore, më thotë “Drejtoreshë, qe

vajzën.” Vajza e kish emrin Barie. “Qe Barien, ban çfarë të dush, çoje në shkollë, ban çka të dush. Është e jotja!” Edhe unë mbeta. Ishte pak një moment... (buzëqeshë) Sa i kishim thanë ma herët, nuk kishte pranë dhe mas disa ditë e kish pa, edhe ishte me të vërtetë një moment emocionues. Vajza vazhdoi shkollën, e sot punon si motër medicinale. Ka raste shumë, momente emocionuese që kemi përjetu. Por o kon shumë me rëndësi se jemi fokusu në diçka edhe i’a kemi përqendru, edhe deri në fun ja kemi dalë. Nuk e kemi lanë punën, veç hajt me thanë një herë, me lanë. Po thom ka pasë edhe raste kur ata vetë kanë ardhë, na kanë lutë.

Ka qenë edhe një moment shumë i rëndësishëm që është me cekë edhe takimin e parë Motrat Qiriazit që asht majt në Romajë. Atëherë, përveç që është themelu dega, edhe organizimi, viti 1989. Aty mas 90tave, ka qenë një moment shumë prekës aty në tubim, një gru ka falë gjakun e burrit, se ishte edhe lëvizja për pajtimin e gjaqeve³, edhe natyrisht edhe na kemi ndihmu sa kena pas mundësi në atë drejtim. Mirëpo, ajo grua kur kishin shku kta të Këshillit të Pajtimit, nuk ja u kish falë gjakun, mirëpo vendosi atë ditë në tubimin e Motrave Qiriazit, që ishte ai tubimi i madh. E fali atë gjak, edhe ka qenë një moment shumë historik, ku ajo gru e fali gjakun e burrit në prani të manifestimit të grave të shoqatës Motrat Qiriazit në Romajë të Hasit. Është një rast... Pastaj, tek aktivitetet që përmëna të kurset e shëndetsisë, asht shumë me rëndësi me cekë se ne natyrisht krahas edukimit për nevojat personale të femrës, për shëndetin e saj, ne kemi fillu edhe me doktoresha që vinin nga anë të ndryshme për të na ndihmu gjatë.

Kemi fillu t'i ndihmojmë e t'i mësojmë gratë në mënyrë praktike për ndihmën e parë, gjë që ajo ma vonë na u ka gjetë në luftë. Mirëpo, për t'i aftësu ato për ndihmë të pare, u dashtë me pasë edhe mjete, kështu që kemi organizu mrena për mrena komunitetit disa fshatra t'i bëjmë edhe disa mini ambullanta, kështu të vogla, të fshehta për me i pasë materialet e shëndetsisë aty të rezervum. Përveç që ka qenë këtu ambullanta Nënë Terëza këtu në Breg të Drinit kemi pasë edhe disa vende të fshehta të cilat kanë qenë edhe për ndihmë edhe për noj rast ma specifik, edhe pse këto kanë qenë shumë të rrezikshme për pushtetin. Kanë qenë shumë me rrezik për neve se kur më kanë marrë në pyetje, domethënë më kanë pytë shumë për këto gjana. Pse? Kam pasë shumë fat që kam shpëtë se përndryshe ka qenë rrezik për mu dhe aktivitetin.

Mbaj mend po ashtu shumë histori... ka qenë hapja e dy shkollave. Patjetër më duhet të kthehem edhe njëherë, gjithë ata njerëz, burra dhe gra në Gjonaj kur u hap shkolla e mesme, gjimnazi. Ka qenë atëherë ministri që erdh Xhavit Ahmeti, i cili na kishte ndihmu për me e hapë, se nuk ishte lehtë me hapë shkollën, edhe ka qenë një masë shumë e madhe e popullit të Hasit. E kanë mirëpritë atë ngjarje. Pastaj edhe hapja e qendrës tonë me aktivitetet tona që ka qenë qendra kryesore në Gjonaj, qendra e gruas Motrat Qiriazit. Aty kanë qenë dhoma ku kemi mbajtë takimet, kurset, biblioteka. Por, gjatë kësaj ne nuk kemi lanë edhe jetën kulturore anash që përmes këtyre aktiviteteve kulturore ne e kemi ofru komunitetin. Kemi pasë fatin që kemi pasë edhe Safete Rogova, artiste. Ajo në atë kohë, krahas aktiviteteve të shumta që ka ba, ka realizu përmes shoqatës edhe radio dramën. Kemi botu pastaj një libër të një shkrimtareje nga Hasi, Margit Markaj. E kemi përkrah edhe atë libër të saj me një histori ku tregon për një vajzë që ka pasë vështirësi me shku në shkollë dhe i’a ka arritë me shku në shkollë. Pastaj zonja Safete me artistat e ka ba radio dramë në kasetë, që atë radio dramë ne e kemi marë pastaj nëpër aktivitetet tona dhe e kemi lëshu, edhe i’a kemi dhënë grave dhe e kanë majtë gratë. Ka

³Në 1991 një lëvizje masive e pajtimit të gjaqërave të armiqësuar u fut në mes popullit shqiptar në Kosovë. Ishte në marrë nga një grup i studentëve, ish të burgosur politikë të cilët i’u drejtuan studiuesit të folklorit Anton Çeta dhe figurave të tjera të larta në akademi për të udhëhequr procesin. Lëvizja pajtoi me mijëra raste, dhe u bë lëvizje për bashkim kombëtar.

qenë një motiv për vajzat e reja kur e kanë dëgju atë radio dramë. Atëherë, edhe janë motivu me vazhdu shkollimin.

Ka qenë ky projekt shumë i rëndësishëm, që na ka ndihmu shumë, thjeshtë, por shumë i rëndësishëm në atë kohë, se ne s'kemi pasë as televizionin si duhet në atë kohë. E ka qenë po ashtu një projekt i rëndësishëm që na ka ndihmu shumë, thjeshtë, po shumë i rëndësishëm në atë kohë se na nuk kemi pasë as televizionin si duhet atë kohë. Po ashtu janë majt aktivitete të ndryshme në kuadër të shkollave. I ndihmonim, bashkëpunonim me shkollat, këto folklorin hasjan, veshjet që i kemi tradicionale, manim programe të ndryshme për ditë të shkollave, për ditë të mësuesës, po çfarëdo aktiviteti tjetër që mundoheshim me zhvillu. Po ashtu kemi organizu edhe aktivitete sportive. Ka qenë një sport, dhe është akoma këtu të ne në Has, volejboli. Është një sport të cilin e lujnë shumë vajza, krahas meshkujt, po edhe vajzat. Ne duke pa me aktivistët që po ka të interesum, me një organizim të vogël e për t'i stimulu, jo me maicë, jo diçka, edhe në kuadër të mrena për mrena Hasit, majshim turnire të volejbollit për vajza që ishte diçka shumë e mrekullueshme. Edhe ishte shumë e rëndësishme se vinin me e pa edhe prindërit vajzat e tyre duke lujtë volejball.

Po krahas aktiviteteve të shumta që kemi bo si shoqata Motrat Qiriazit këtu në Has, natyrisht në atë kohë, kemi bashkëpunu edhe me disa shoqata të tjera që fillun me u kriju edhe në vende të tjera të Kosovës. Por ajo çka është shumë me rëndësi është se ne si shoqatë kemi pasë një bashkëpunim të mirë rajonal. Shoqata Motrat Qiriazit kishte bo një jehonë të madhe në vendet e ish Jugosllavisë në atë kohë qysh ishin, edhe bashkëpunojshin, edhe merrshin pjesë në ato takimet e rregullta. Dhe, natyrisht bashkëpunonin për projektidet sepse ne patëm rastin me pa luftën në Bosnjë që ndodhi dhe ato përvojat e luftës në Bosnjë, edhe Motrat Qiriazit edhe ne si aktiviste ku ishte mundësia, kishim ngritë zërin kundër asaj çka ishte bërë, çka kishte ndodhë në Bosnjë. Prandaj, në vitet 1995, 1996, 1997 deri në prag të luftës të madhe në Kosovë, ne kemi qenë vazhdimisht në kontakt me shoqatat e grave në rajonin e Ish Jugosllavisë, në këtë rast me qendrën e tyre që kanë pasë në Beograd. Unë personalisht vetë kam marrë pjesë në disa konferenca që kanë qenë në Novi Sad, Tërshnovac. Ishin ato takimet e ndryshme të grave regjionale ndërkombtare, që ishin Gratë në të Zeza, gra të ndryshme vende të ndryshme të ish Jugosllavisë, jo vetëm nga Serbia, po nga e gjithë ish Jugosllavia, si Bosnja, Kroacia, Sllovenia. Kishin një bashkëpunim të mirë, krahas saj natyrisht që për mua personalisht ishte një përvojë e mirë sepse aty pata rastin me u njoftë me aktiviste të ndryshme të botës që punonin për të drejtat e grave, pra kishte feministe shumë të fuqishme, që unë kam pasë kënaqësinë dhe nderin, natyrisht m'u ka dhanë mundësia me i njoftë edhe me taku edhe ka qenë një fuqizim edhe një motiv shtesë për mu për të punu. Sa herë që jam kthi nga ato takime apo konferenca të ndryshme, kur kthehesha këtu vazhdimisht shtohesh vullneti dhe dëshira për me punu edhe ma shumë, sepse kishte shumë shembuj të grave të fuqishme që kishin bo edhe ato ndryshime në vendet e tyre ashtu siç na mundoheshim, edhe unë me shoqet e mia mundoheshim të bënim ndryshime këtu në Kosovë, konkretisht në rajonin e Hasit, sepse nuk ka qenë lehtë me bo ndryshime, do të thotë me ndryshu jetën për të mirë, sepse dikur jeta ka qenë bukur e vështirë këtu në Has.

Ka qenë një rajon, thashë më herët që është marrë veç me gurbet. Burrat kanë qenë në gurbet dhe grujat ka qenë vetë në shpi çdo gjë. Ajo ka punu krejt punët e shpisë, edhe të fushës është detyru, sepse nuk e ka pasë burrin të shpia, me rritë fëmijë, me qitë bukë, me dalë edhe në fushë me punu. Domethanë ka qenë bukur e vështirë për jetën e gruas këtu në Has, plus kanë qenë atëherë infrastruktura, rrugët të pandërtume, nuk ka pasë ujë. Ky ka qenë një problem i gruas në Has, me shku me bartë ujë me ugarë. Kemi mbajtur ujë, që e kam mbrri edhe unë vetë si fëmijë deri vonë. Kemi mbajtur ujë për me siguru jetën e për pastërti. Kanë qenë disa momente të vështira, disa kushte të vështira të jetës këtu, por gruaja vërtetë ja ka arritë me mbijetu. Kanë qenë do storie të bukura shumë, të shkrueme edhe në gazetën tonë Të jesh grua edhe Etja që ka qenë gazeta. Na angazhonin që edhe këto ngjarje me i shkrueme në gazetë. Thashë nuk

ka qenë e lehtë të jesh grua këtu në Has, në ato periudha, në ato kohë, por vërtetë gratë këtu kanë qenë shumë të forta këtu, shumë të fuqishmë. Qysh ka qenë edhe nana ime, qysh na ka rritë, në atë kohë, tu korr grunin, tu kry punë shumë të randa në fushë, krahas kësaj edhe me një veshje të bukur të randë tradicionale që ka qenë, nuk ka qenë lehtë me punue, le mo me vëshë e me mbajtë tanë kohën.

Mirëpo, nëse ndalemi sot, po edhe atëherë bëjmë ndryshime e krahasime të jetës këtu të na, ka dallime shumë të mëdha. Unë muj me thanë, na i ndajmë ato me periudha, domethonë vitet '90 '99, është një periudhë kur kanë fillu ndryshimet, po burrat hasjanë kanë qenë jashtë Kosovës. Kanë pa ndryshime ata, prandaj edhe na përkrahnin që ne me i ba ndryshimet, që bëheshin këtu përkrah shkollimit e edukimit e kështu më rradhë. Pastaj vjen kjo periudha tjetër, periudha e luftës. Hasi ka qenë zonë kufitare me Shqipërinë dhe e dimë se krejt lëvizjet këtu të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që janë ba, janë ba në këtë pjesë, pastaj kishim pak ma shumë vështirësi me zhvillu aktivitetin. Në fund 1998, në fund të 1998/1999 kemi pasë ma pak aktivitete si shoqatë. Tu e pa që fillun lëvizjet e grave dhe njerëzve të ardhur nga rajone të tjera, ne jemi orientu në një lagje në Prizren, Arbana quhet, ish Dushanova. Aty kemi fillu aktivitetet me gratë që ishin zhvendosë nga rajonet e tjera ku në 98ën kishin fillu luftimet. Është një pjesë shumë e rëndësishme e aktiviteteve Motrat Qiriazit në vitet '98/99, pak pa fillu lufta e madhe, që kemi bo në Arbanë, paralagje e qytetit të Prizrenit. Edhe aty i kemi majtë gratë, kemi përgatitë kurse të ndihmës së parë.

Për gratë kemi organizu edhe ndihma me i strehu ato familje që fillun me lëvizë mrena për mrena Kosovës prej zonave ma të rrezikume. Është edhe kjo një periudhë, bukur e vështirë, bile aktivistet që vinin, Igballja, Safetja e kishin më të vështirë me ardh në Has, edhe shumë aktiviste të tjera që vinin me na ndihmu, sepse ishin bo postbllloqet e policisë. Kufijtë ishin blloku dhe boheshin kontrole shumë të mëdhaja. Ishte pastaj edhe atje në hymje të Prizrenit që e dinin ato sa me vështirësi i kanë kalu, sidomos kur sillnin libra apo materiale diçka. Ishte shumë vështirë. Osht kon shumë me rëndësi se një moment shumë i rëndësishëm kur shoqata Motrat Qiriazit ka gjetë mundësi për me furnizu hamallin Nënë Terezë këtu në Breg Drini. Dhe një kontigjent duke ardhë, një furgon me mjete na kanë zanë në Arbanë dhe ka qenë problem, ajo motra medicinale... dhe na mezi kemi kalu. Për fat atë ditë nuk ka pasë barna që kanë qenë të dërgume për të plagosur, për këto, po kanë qenë do mjete të tjera, se përndryshe ka qenë kjo periudha e vështirësisë e lëvizjes, së lëvizjes me vështirësi këtu në rajon. Aktivistet tona kanë punu edhe në Mitrovicë atje, mos t'a harrojmë. Është shumë me rëndësi grupi jonë me aktivistën tonë Sanije Voca, e cila qysh në 98ën ishte atje. Ka fillu edhe ajo aktivitetin me shumë vështirësi, kohë pas kohe ndonjëherë edhe e kemi vizitu, po kanë qenë ato periudhat edhe atje bukur të vështira. Domethanë jemi tash në momentin kur fillon lufta e madhe, në prag të saj edhe këtu ato aktivitetet tona, ajo lidhja që u ba me njërit, edhe ato pak ilaçe e barna e që i patëm sidomos këtu në Nënë Terezë edhe në disa punë të vogla në këtë periudhë, do të na gjinden shumë.

Ndoshta do të vazhdoj me momentin, periudhën, ngjarjen e luftës këtu, asht ni moment shumë i rëndësishëm. Hasi si rajon ishte zonë kufitare dhe vinin forcat e mëdha të policisë e vazhdimisht qarkullonin që mundoheshin me i zanë ushtrinë tonë që kalonte dhe ne ishim bukur shumë të rrezikum.

Lufta

Lufta filloi në Kosovë me bombardimet e NATO-s, filloi lufta ma e madhe, e pandërprerë, e cila edhe ktu të na në fillim u mirëprit e mendum se me atë do të kalonte shpejt, nuk do të kemi probleme. Por për fat të keq, ditën e tretë të bombardimeve fillun edhe problemet dhe masakrat e ndryshme

këtu, është shumë me rëndësi ngjarja e cila ka ndodhë në Krushën e Vogël⁴. Ishte ditë e premte në mëngjes, kur ne u zgjuam prej këtu pozitës të fshatit tonë dhe pamë që matanë Drinit atje {dëfton nga lumi}, ky është Drini, e matanë është Krusha e Vogël; dhe që në mëngjes u panë shtëpitë duke u djegur. Mirëpo, ne nuk e dinim drejtpërdrejtë se çka po ndodh aty se çka është t'u ndodhë në fshat, dhe dikun ka mesdita, ka ora dymbëdhjetë, ne pamë ni grup njerëzish që kishin fillu me lëvizë prej fshatit e t'u ardhë deri të Drini aty {dëfton nga lumi}. Dhe ne prej kësaj ane përcjellnim me vëmendje, une kisha edhe vëllaun me dybli, mjete për me shiku ma afër, dhe pamë që ato gra ishin ata njerëz edhe turmë ishin gra dhe fëmijë dhe që të gjithë kishin ardhë aty {dëfton nga lumi} në prag të Drinit, ishin mbledhë.

Mirëpo anej fshatit digjej, ne knej nuk dinim çka ndodhi, nuk mujshim me komuniku drejtpërdrejtë, por ma në fund une i thashë vëllaut se ato gra dhe fëmijë nuk kanë ku shkojnë duhet patjetër, duhet me dalë me i marrë me diçka. Po meqë Drini ishte shumë i madh, e ish ngritë niveli, ishte vështirë me kalu e urë këtu s'ka, atëherë unë me gjithë vëllaun, vendosëm me e marrë traktorin, këtë traktor e kemi akoma, është ma i madh, ma i naltë, e dhezëm bashkë edhe fillim me shku të lumi edhe me kalu Drinin me pa çka është aty. Ka qenë ni moment shumë i vështirë kur kam dalë matanë me traktor, kur kam pa aty gjithë ato gra dhe fëmijë t'u kajtë, t'u bërtitë, të shqetësime, të tmerrime, nuk dinim se ku i kanë burrat, edhe ishte vështirë. Por, megjithatë në ato momente, më erdhi ni forcë nuk e di as vetë se nga, ajo forcë ajo energji për me i ndihmu atyre njerëzve dhe kështu i ngarkojsha gratë dhe fëmijët në rimorkion e traktorit, vëllau i përcjellte knena të lumi edhe vajza e axhës e kto tjerat qëndronin n'këtë anë, i merrnin nëpër shtëpija dhe i strehonin. U dashtë me kalu disa herë Drinin ashtu me traktor sepse ishin shumë, diku 300-400 vetë, gra dhe fëmijë, ishin shumë ato. Ishte gjendje shumë e vështirë për ne, se ato qanin e bërtisnin, nuk dinim se çka ka ndodhë me ta e çka po ndodhë me njerëz t'atyre, e ne brenda ni kohe arritëm me i pru të gjithë këtu {dëfton nga shtëpitë} në shtëpijat tona të fshatit t'u i strehu.

Dhe, kuptum ma vonë se të gjithë ata burrat që i'u kishin ndalë, 120 burra atje i kishin masakru n'Krushë të Vogël, i kishin vra dhe ne nejtëm këtu katër netë e pesë ditë bashkë me ato gra dhe fëmijë, në shpijat tona. Më është dashtë me e organizu barna me i'u dhanë me i qetësu, sepse ishin shumë të traumatizime, kemi pas dy të plagosuna, të cilat kur kanë kalu të shpijat e fshatit i kanë ra copat e granatës që kanë gjujtë ata... e me i'u dhanë qetësues, me i'u shëru ato plagë. Besa me i siguru ushqim se ishin shumë veta, fshati ish ngarku, kishte edhe të tjerë që kishin ardhë, nuk ishte lehtë, për njerëzit tanë kishin frikë, e t'them t'drejtën une pak me iniciativën time, mora pak si krye në veti kit iniciativë, sepse ishte rrezik t'i sjellësh ata njerëz këtu dhe mund të vinin forcat këtu, se nuk ishim ma të mbojtun por na dukej pak ma mirë, se mali afër, qysh me i lanë ato aty, se policia i'u kishte thanë shkoni mytni në Dri, e nuk i kishin leju me shku as ka Prizreni, e as ka Gjakova dhe ishte e asht ni ngjarje shumë e randë, e vështirë për mu personalisht.

Emocionalisht ka qenë ni moment shumë i vështirë, por edhe për familjen me i pa ato gra t'u kajtë, ata fmi t'u i lypë njerëzit e vetë, ishte vështirë me i qetësu, por ashtu disi arritëm me ni organizim të mirë, i rehabilitum për katër netë e pesë ditë sa qëndrum këtu n'fshat. I sigurum të gjitha dhe pas pesë dite na dhanë urdhër të gjithë me e ishu fshatin, me shku të gjithë në

⁴Masakra e Krushës së Vogël me 26 mars 1999 në shumë dokumente është dokumentuar në shumë raporte të lajmeve dhe gjithashtu në raportin e *Human Rights Watch, Under Orders* (2001). Githë burrat e fshatit ishin vrarë, trupat e të cilëve asnjëherë nuk u gjetën.

Shqipëri. Edhe shkum bashkë me ato gra, me fmitë vazhdum rrugën për në kufi e u larguam për në Shqipëri.

Po jeta si fëmijë ka shumë momente të ndryshme fëmimore, më kujtohen momentet kur zgjoheshim herët në mëngjes për t'u përgatitë me shku n'shköllë, dhe natyrisht derisa bëheshim gati zakonisht nana përgatitë diçka ushqim të shpejtë na gatunte kuleqë, kuleqët janë brum. Prej brumit të bukës i ndante, i pjekte më shpejtë dhe natyrisht me ni copë djath dhe kshtu u përgatitshim me shku n'shköllë. Është shumë me rëndësi se rruga jonë për me shku n'shköllë ka qenë rrugë nëpër mal, dhe ne bashkë me shoqe dhe shokë udhëtonim gjithë rrugën derisa mbërrinim në shkollë, na i përsërisnim mësimet.

Me ni vullnet të madh shkonim dhe ton atë rrugë e shfrytëzonim me i msu vjershat ose këndonim, ose naj msim e përsëritshim dhe paramenoje katër kilometra rrugë, dhe veç kur e shihnim veten të shkolla! Pastaj ka edhe momente të bukura si fëmijë kur pritshim festat e ndryshme, si fëmijë kur ato ditë kanë qenë ma të veqanta për ne; na kanë ble tesha të reja, na kanë qitë ushqime pak ma ndryshe se tjera dite. Ka pasë dhe fshati ka bukuritë e veta, edhe pse kanë qenë kushtet ma t'vështira kanë qenë momente të mira. Pastaj, unë si fëmijë përveq qe kam shku në shkollë edhe jam kujdes edhe për bagëti, m'kujtohet qysh i kom rujtë delet, kem pasë dele e ka qenë ni kënaqësi e veqantë t'i marrësh delet t'a mushësh strajcën e vogël që t'a ka shkepë nana me bukë e me djath (buzëqeshë) e të dalësh livadheve e fushave tona të bukura dhe t'i kullosësh ato dele. Ka pasë momente të bukura e lojna që i zhvillonim atje t'u i rujtë delet që lunim me lojna të ndryshme, nuk kishim ne atëherë kukulla apo nuk kishim neve televizorin e ato gjërat tjera për t'i shiku po ne vazhdonim t'improvizonim lojna t'ndryshme e kshtu kalonim ditën domethënë të gëzueshëm.

Nicole Farnsworth: A keni pasë ndonjë problem a noj sherr kur keni qenë e vogël?

Marta Prekpalaj: Jo kshtu naj sherr jo, nuk kam qenë fmi i sherrshëm, nuk kam qenë shumë problematik; jo nuk m'kujtohet noj problem, noshta nanën me vetë [qeshin], nuk m'kujtohet ndonji problem, jo.

Po, do të veçoja edhe kujtimet e mija shumë të bukura për nanën loka time, kshtu e quaja nanën e babës tim, ajo ishte ni grua tamam malësore e Hasit e cila kishte përjetu vite shumë të vështira. Mirëpo vërtetë ishte shumë ni gru e mençur e zgjuar, ajo më mësonte çdo gja, t'u fillu nga gjërat elementare të punëve e deri te nganjëhere... Edhe pse ajo nuk dinte mirë shkrim e lexim, ajo ishte autodidakte na i kontrollonte edhe detyrat e shtëpisë a i kemi ba mirë a jo. Ajo kishte mësuar të gatujë, ajo m'ka mësu të qep rrobat sepse në atë kohë duheshe me i qep rrobat, nuk kishim cdo herë të reja dhe ka pasë ni stil të veqantë të qepjes së mirë se si i theshim ne me e arnu harnin, mësonte gjana. Poashtu, tregonte ngjarje të mahershme që kishin përjetu, m'kshillonte e edukonte, por mbi të gjitha nga ajo kam marrë ni msim shumë të mirë se ajo ishte shumë humaniste, ajo i ndihmonte njerëzve. Njerëzit këtu në fshat kur kishin nevojë për diçka, për ndoni gja, ajo gjithmonë thoshte se "Duhet t'i ndihmojmë njanjitetrit, sepse nuk ban pa i nihmu." Edhe ka qenë ni person shumë i mirë për mu e shumë i dashtun dhe shumë e zgjuar. Edhe pse nuk kishte shkollë ajo ishte mësuar vetë me shkru dhe lexu, vetë ajo ishte autodidakte, edhe e donte shumë shkollën. Bile, mu m'ka ngel marak sepse ajo ka vdekë kur unë kam qenë në shkollë fillore, po t'kishte qenë ajo me m'pa ishte diçka ni mrekulli e veqantë sepse ajo e ka dashtë shumë shkollën.

Me largimin nga Kosova që na përzonën krejt popullatën. Edhe unë bashkë me njerëzit e mi të fshatit tim edhe të Krushës të Vogël edhe ashtu turma, si na përcollën për Shqipëri dolëm në

pjesën e Prizrenit në kufi dhe Vërmicë dhe vazhduam për Kukës dhe në natë qëndrova aty në Kukës. Ishte në moment shumë i vështirë aty, ishte në numër i madh i njerëzve me traktora, me gjana të ndryshme, ishte me të vërtetë moment shumë i vështirë. Edhe pse, ndoshta atje ndiheshim paksa më të sigurtë, ishte vështirë sepse shumë prej njerëzve që ishin aty kërkonin njerëz, ishin nda njerëzit, kishte llojloj pamje.

Si shumicën e popullatës të Kosovës që i larguan me dhunë për jashtë, edhe neve na larguan, pothuajse i gjithë rajoni i Hasit brenda në ditës u zbras këtu krejt. Ne si ishim bashkë edhe me gratë e fmitë nga Krusha e Vogël me traktora me çka mbërritëm, u detyruam me u largu me lshu shpinë. Natyrisht edhe ato nuk ishin momente të lehta dhe kalum në pjesën e Vërmices në Prizren, dulëm në Kukës edhe atje ishte në ngjarje, në moment shumë i vështirë, i randë sepse kishte familje të shpërndara që kërkonin njani tjetrin, ishin në numër i madh i njerëzve që nuk dinin nga t'ia mbanin.

Megjithatë, organizimi që ishte ba në atë anë fillun me i shpërnda nëpër pjesë të Shqipërisë; neve na qëlloi fati që familja jonë të shkojë në Durrës. Meqë i kishim të afërmit në Kroaci, bisedum edhe nihere ndoshta mos është e mundun, nuk dinim se sa po zgjatë lufta si po shkojnë gjërat, por ata personat që na çunë me atë automjetin na dërgun me në vend shumë të përshtatshëm masi kishim në shumë fëmijë. Se familja ime në ato momente vëllazënit kishin të gjithë fëmijë të vegjël edhe të axhës kishim rreth dhjetë fëmijë të vegjël, prej moshës pesëgjashë muje deri në gjashtë, shtatë, tetë vjet, kështu që kishim edhe pleqtë. Ishte pak problem edhe ata na dërguan në një kamp afër kishës në Durrës, në një vend ku ishte ku u strehum.

Ai kamp fillimisht kur shkova unë ditë të para, kishte pak banorë dhe meniherë aty unë dhe vajza e axhës si aktiviste që ishim, nuk mund të nejtëm duarkryq dhe meniherë u kyqëm në qendrën ku regjistroheshin refugjatët edhe ku njerëzit punonin dhe ramë në kontakt me disa aktivistë të shoqatave gjermane. Ishte kjo lidhja e kishave gjermane, ASBja, e cila ish kanë t'u punu aty dhe Caritasi, edhe unë u prezentova se jam aktiviste e shoqatës që kshu kshu kemi punu. Ata e mirëpritën këtë dhe u kyqëm aty meniherë dhe fillum me punu menjëherë me njerëz të ardhur, merrnim njerëz nga kur i sjellnin në qytet i strehonim. Fillum me e zgjeru kampin ku isha nëpërmes Caritasit dhe kishës ata prunë shumë çadra e u rrit kampi, edhe natyrisht e pash të nevojshme që tani me punu aty drejtpërdrejtë në kamp. Ka pas shumë momente shumë raste të vështira me punu me gra, unë m'duhej me vrapu tan ditën në terren dhe prapë në mbramje më pritshin gratë, për çdo mramje të bajme ndonji aktivitet, që traumat e atyre diqysh t'i kalojmë se ishte vështirë.

Më duhet të përmen në rast shumë specifik që është histori shumë... në grua nga Drenica, Shkurte Gashi e cila kishte ardhë shtatzanë me dy fëmijë dhe burrin i'a kishin vra rrugës në Gjakovë, i'a kishin ndalë, dhe vala e refugjatëve e solli aty në kampin tim. Ajo grua nuk kishte... nuk ka folë 2 javë ditë, kanë angazhu Caritasi llojloj psikologë dhe nuk kanë arritë me e shti me folë. Edhe unë e pashë që nuk bënë punë psikologët, e unë dalë ngadalë e vizitoja së paku tri herë në ditë, i çoja gjëra ushqimore, me fmi bisedoja e nuk i bëja pyetje asaj, sepse e pashë që me e gjet në mënyrë jo me ba pyetje, po veç me nejtë me të. E mbas dy jave ajo grua filloi me fol me mu, vetëm me mu, edhe psikologët e tjerë që punojshin thanë "çka i bane, çfarë fuqie?" Unë natyrisht që isha përkushtu dhe i rrija afër, sa kisha punë me ta, duke e përkdhelë, duke mos i ba pyetje për mos me e provoku. Pra ishte kjo në ndjenjë, në fuqi që domethanë më lidhte me mu me punën e grave dhe përvoja ime që kisha ktu me vite që kisha punu. Edhe domethanë arrita atë gru me e aktivizu, me e qetësu e rehabilitu, se ajo donte... pastaj e kishte pretendu me e bo abort fëminë, mos me jetu ma se nuk mundte me e paramenu jetën pa burrin e saj me ata fmi të vegjël.

Pra, kшту sa ndejtēm aty diku rreth dy mujë e sa na ra me nejtë si refugjatë, në atë kamp kam qenë e angazhuar me aktivitete duke ndihmu njerëz, duke i lidhë njerëzit me familje. Shkoja edhe në Tiranë një herë në javë, përmes të shtypit me u munu me i gjetë njerëz, me i ndihmu sa të mundim. Thua jse prej momentit kur ka fillu lufta ktu, prej kur i kam sjellë gratë e fëmitë e Krushës të Vogël, deri momentin kur jom kthy nuk muj me paramenu a kom fjetë ma shumë se katërpesë orë mrena natës. Domethanë ka qenë aktivitet i plotë tan ditën, tan natën pa ndërpre, me ni vullnet nuk e di as vetë nga e merrja, por veç kisha dëshirë sa ma shumë me i'u niham njerëzve, sa me qenë afër me ata njerëz, me ato gra e me ata fmi që ishin shumë të traumatizum.

Aktivizmi

Menjëherë mbasi u kthym nga Shqipëria si refugjatë që ishim, natyrisht shoqata Motrat Qiriazit u takun aktivistet se ishin të gjitha të shpërndara në të gjitha anët. Safetja dhe Igballja kishin qenë në Maqedoni, Sanija pak në Mal të Zi dhe natyrisht në Shqipëri dhe u bashkum natyrisht dhe fillum punën menjëherë dhe atë punë natyrisht shumë intensive. Krahas shumë aktiviteteve që kishim si shoqatë në këto rajonet ku ishim ma heret si në Has, e në të gjitha anët tjera, unë bona një kërkesë që ma aprovun shoqata, që të vazhdoj me punu me gratë e Krushës së Vogël, se ne para luftës me ato nuk kishim punu, vetëm në luftë që ishim marrë. E zgjeruam aktivitetin edhe ne Krushë të Vogël.

Pra, ishim në një periudhë të emergjencës ku shoqata kishte shumë punë dhe kishte shumë projekte. Kishim planifiku shumë projekte, në rradhë të parë për t'i ndihmu këtyre grave. Nuk ka qenë e lehtë, jo për të sjellë donacione ndoshta, po për të punu me ato gra, sepse ato ishin shumë, shumë të mërzitura, shumë të traumatizume. Ishte vështirë gjithsekush me i ra me punu me dëshiru me punu, sepse vinin shumë fshatra të tjera, mirëpo shumë të vështirë e kishin. Unë meqë isha lidhë edhe gjatë luftës me to, atëherë fillum menjëherë hapëm qendrën atje në Krushë të Vogël të gruas, dhe fillum me aktivitetet tona, nojherë me gratë t'u i rehabilitu ato, t'u i sjellë ndihma përmes shoqatave të tjera në bashkëpunim. Edhe donatorë të shumtë, të panumërt që kemi sjellë, që nuk di nga të i'a filloj, se kemi pru shumë.

Natyrisht fillun aktivitetet e grave. Ato fillimisht vizita nëpër shtëpia se nuk donin me dalë, se akoma nuk pajtoheshin që kishin humbur njerëzit e tyre më të dashur. Pastaj gradualisht me qendrën, për secilin grup, për vajza kish aktivitete, për gra kishte aktivitete, por edhe ato pak më të moshume nuk i linim anash. Për shembull atyre pak më të vjetra i kishim angazhu me punu punë dore, që përmes edhe aktiviteteve të ndryshme ne arrinim me i'u shitë jashtë. Pak edhe ta humbin mërzinë, ta humbin kohën edhe të zhvillojnë aktivitete dhe pak përfitojnë. Fillum me projektet e para, me kurset e ndryshme fitimprurëse. Ne gratë e Krushës, gratë e veja, që nuk kishin burra, një grup kërkun kurse të rrobaqepsisë që të gjitha e kryen edhe sot vazhdojnë ende të punojnë edhe të përfitojnë, e të mbajnë familjet e tyre. I kena sjellë edhe makinat qepëse, edhe krejt ato materiale të ndryshme. Nganjëherë, organizonim edhe punë kolektive në qendër. Për shembull, spitalit i kishim qep pizhame, uniforma, perde, bashkë me Kinderbergun e shoqatat tjera, bashkëpunonim. Pastaj një grup i vajzave dhe të rejave kërkuar edhe kurse të informatikës, domethanë filluan me kompjutera, të gjuhës angleze. Pastaj kemi majtë edhe kursin për kuzhineri në Krushë edhe në disa fshatra të Hasit, ku o kon shumë prezent gratë, kanë dashtë të mësojnë pak ma mirë, me detaje se si të zijnë.

Por, një ndër projektet që është shumë madhor dhe është shumë i rëndësishëm për Krushën, që në fillim nuk kanë besu njerëzit që mundet me u ba, ka qenë kursi për shofere, për me nga

makinën, do të thotë me marrë lejen për të drejtu makinën. Kur kemi konkurru për herë të parë si shoqatë, donatorët kanë mendu se është ndonjë projekt luks apo diçka, mirëpo ne i kemi bindë se atyre grave kanë nevojë me i nga edhe traktorit, edhe makinës. Kanë nevojë me kry nevojat e tyre familjare. Kështu diku rreth 50 gra të Krushës së Vogël dhe të Madhe, kanë marrë lejet e makinës, për të drejtu makinën. Edhe sot punojnë, veprojnë me to shumica prej tyre. Në Krushë, është dashtë me mendu për shumë projekte që me qëndru ato projekte ma gjatë, që me ju dashtë grusë për një kohë ma të gjatë për me majtë familjen e vetë.

Pastaj, në Krushë kemi dhënë edhe bursa për fëmijë. Shoqata Motrat Qiriazhi kanë siguru përmes donatorëve bursa për fëmijët mos me i ndërpre studimet. Aty në qendër janë majtë aktivitete të ndryshme edhe kulturore, edhe aty kemi fillu kadalale me fëmijë njëherë se gratë pak nuk donin. Pastaj, edhe me gratë programe të ndryshme, kemi sjellë edhe aktore të ndryshme, aktivitete të ndryshme. Edhe të shëndetësisë kemi organizu kurse, mjeke të cilat kanë ardhë edhe kanë pru, aty i kanë dhanë vizitën. Kemi pasë trikatër vite mjeken një herë në javë që Shoqata Motrat Qiriazhi i ka organizu në bashkëpunim me donatorë lokalë pastaj. Edhe gratë kanë pasë ato vizitat pa pagesë, edhe kanë qenë një numër i madh i aktiviteteve të shumta, edhe një përkrahje e madhe që i kemi dhanë atyre grave derisa ka ekzistuar shoqata. Por, përveç punëve, aktiviteteve, projekteve, ne në këtë periudhë menjëherë mbas luftës jemi dashtë me u përballë edhe me një problem tjetër me gratë e Krushës. Kemi organizu protesta, janë shumë të mirënjohura protestat e grave të Krushës së Vogël, prej Prizrenit e deri në Prishtinë, për të kërku njerëzit e tyre të zhdukur. Sot e kësaj dite nuk dihen eshtrat e tyre ku janë.

Nuk ka qenë e lehtë edhe kjo me u organizu, me siguru autobusat, me i çu në Prishtinë, në Prizren me u ballafaqu me ato. Por natyrisht, falë organizimit të mirë që ka pasë shoqata, edhe angazhimit të madh që ka bo llogarja, bashkë me ne, kemi arritë që të i'u plotësojmë ato kërkesa të grave që t'jemi me to edhe në protesta edhe në çdo gjë që ka pasë nevojë që ato me të vërtetë ta ndjejnë që nuk janë vetëm, që dikush do t'i përkrahë ato që të vazhdojnë jetën. Jemi mundu në të gjitha hapësirat m'u kon aty, me i'u gjetë një mundësi, jo vetëm me të mira materiale por edhe me këshilla me gjendjen e tyre emocionale jemi lidhë. Edhe sot e kësaj dite, edhe pse nuk ka aktivitete, të jem e lidhur me to, pra me ato mundësitë që kam mos me ndërpre lidhjet me ato. Pastaj, kemi organizu edhe vizita me çu këto gra me i vizitu edhe gra të tjera në Kosovë. Kemi qenë në vizita në Prekaz, në Drenicë, Reçak, që gratë të dalin, të komunikojnë mes veti, t'i qajnë hallët, problemet e tyre që kanë të përbashkëta. Kanë qenë këto aktivitete edhe të mirëseardhura edhe të rëndësishme për ato, edhe pse ka qenë për neve pak ngarkesë, lodhje, angazhim por, kur kemi qenë të përkushtuara, edhe nuk kemi ndi asnjëherë thujse lodhjen.

Pastaj, ka qenë projekti që sot nuk ekziston, por tri vite ka punu; ka qenë iniciativa jonë, e grave për me siguru një fabrikë, prej gjermanëve, ata kanë pru një donacion. Ne kemi ofru atë mundësi por ma vonë ka pasë probleme që nuk ka arritë me vazhdu punën. Vetëm tri vite ka punu, me mundësitë tona, pastaj e kemi siguru përmes UNACERit [UNHCR] në bashkëpunim me ne, edhe disa vegla bujqësore. Edhe sot vazhdojnë aktivitete të ndryshme të shoqatave të tjera që kanë përfitu gratë në atë kohë, projekte të shumta në Krushë të Vogël.

Mas luftës, jo vetëm Krusha e Vogël, edhe Hasi nuk ka ngelë jashtë. Kemi pasë edhe raste edhe ne Lugishtë, kemi edhe atje gra dhe fëmijë jetima. Në Lugishtë, edhe në shumë fshatra në bibliotekat i rihapen, se na i patën djegë gjatë luftës. Edhe i kemi hapë prapë në Gjonaj, në Lugishtë, në Romajë, por me rëndësi këtu është se në Lugishtë kemi hapë një qendër për fëmijë bashkë me shoqatën. Fillim edhe me ASBnë gjermane ku aty ka qenë një qendër e fëmijëve, e pajisur me të gjitha mjetet

që duhet dhe fëmijët jetima kalonin aty ditën me dy instruktorë që i kishim trajnu përmes shoqatës Motrat Qiriaz. Ka qenë një periudhë e bukur, e gjatë që ka funksionu dhe pak para ca viteve ajo qendër, si një lloj çerdhe apo parashkollor që nuk kishte në këto anë dhe janë zhvillu shumë aktivitete të mira me ata fëmijë. Domethanë jemi mundu që të gjitha grupmoshat me i përkrahë, me i ndihmu.

Tash, po ashtu është me rëndësi të përmendim një aktivitet dhe një aksion të rëndësishëm për Hasin. Më herët kur fola tregova se rrugët e Hasit kanë qenë të gjitha të pa asfaltuara, kanë qenë rrugë me gropa, tepër të vështira për me u tejkalu. Transport shumë pak ka pas, një autobus ka qenë në krejt Hasin. Ne kemi shku me traktora, me kerr, me komë [këmbë] dhe janë lidhë njerëzit, banorët, pavarësisht fshatrave ku edhe ne kemi qenë të kyçun drejtëpërdrejtë, veçanërisht në atë këshillin e ngushtë organizativ për të ba një projekt madhor, për të asfaltu rrugën e Hasit. Kjo rrugë që ka lidhë Hasin me Komunën e Prizrenit e të Gjakovës ka qenë një rrugë 36 kilometra dhe në atë kohë qeveria e Kosovës veç ishte pa buxhet, nuk kishte buxhet të mjaftueshëm. Ishte natyrisht edhe UNMIKu, por ne kemi avoku disa mujë përmes komunave të Prizrenit e të Gjakovës, Ministrisë së Transportit, bashkë natyrisht në Prishtinë kur kemi ardhë kemi pasë përkrahjen e zonjës Safete Rogova, e cila ka qenë krahë me ne me delegacionin tonë. Edhe unë edhe disa aktivistë të Hasit, dhe qysh me gjetë një mundësi se sa më shpejt me asfaltu këtë rrugë, sepse ishte problem se fillun njerëzit me u shpërngulë.

Nuk kishte kushte, edhe shpia kishin në shumë fshatra të djegura, edhe rrugë jo, edhe ujë jo, atëherë neve morrëm iniciativë me banorët e fshatit me gjetë mjete për me fillu projektin. Ishte një mundësi përmes Ministrisë së Transportit, që të na siguronin disa mjete, jo si banore, atëherë mund të asfaltohet rruga. Kështuqë unë bashkë me katër aktivistë të tjerë të Hasit shkuam në Kroaci bashkë atje. Organizuam njerëzit tanë që i kemi atje me furra, bukëpjekës edhe grumbulluam mjete me ble 600.000 euro. Ka qenë diçka e pamundur. Nuk kanë besu as donatorët, se ka kësi njerëz të vullnetit të mirë, ka kështu njerëz që munen me u organizu diçka të tillë dhe ato mjete natyrisht që janë derdhë në bankë. E i kemi dorëzë në Ministri të Arsimit, edhe në Ministri të Transportit edhe brenda një kohe shumë të shkurtër ka fillu ndërtimi i rrugës, asfaltimi i rrugës që sot kjo rrugë ka ndryshu jetën tërësisht të Hasit edhe banorëve të Hasit, të rajonit, që sot vërejmë një ndryshim të madh. Nuk kemi çka flasim më për shkollimin se veç ajo është tejkalu. Vajzat e djemtë shkojnë normalisht në shkolla të mesme, të larta, fakultete. Është vërtetë një ndryshim i madh. Një kënaqësi e madhe kur shoh këto gjëra, gjithë këtë angazhim që nuk mund të thuhet të gjitha përnjëherë. Jemi bashkë me shoqet e mia, se unë nuk kam qenë vetëm kurrë.

Moment shumë të rëndësishëm në vitin 2006, kur janë nderu me çmimin në mesin e shumë aktivisteve të botës nga Fondacioni për Paqe në Gjenevë, i cili ka nda këtë çmim për gratë që bajnë ndryshime në viset rurale. Kam pasë fatin që të jem edhe unë në mesin e atyre grave sa kanë qenë nga Evropa, vetëm tre, unë e treta, përveç Italisë dhe Francës. Për mu ka qenë një moment shumë i rëndësishëm në jetën time, të cilën është vështirë me e përshkru. Ka qenë shumë emocionale kur kam kuptu se natyrisht

Rrjeti është ai që më ka nominu, më ka propozu, Rrjeti i Grave, si aktiviste që kam punu edhe kam ba ndryshime. Është ba ndarja e atij çmimi në Prishtinë me një organizim ku ka pasë njerëz nga Hasi, e shumë nga Prishtina, nga të gjitha përfaqësueset, nga të gjitha shoqet, koleget e mia aty dhe asht ba një moment, një kurorëzim të themi i angazhimit të punës time edhe një vlerësim. Edhe pse njeri kur punon, edhe gjatë punës si aktiviste që kemi qenë, nuk kemi mendu për ato

gjëra se a do të shpërblehemi a nuk do të shpërblehemi. Na kemi punu të themi punë humanitare, vullnetare në të gjitha fushat, që t'i ndihmojmë njerëzve. Po t'u i ndihmu gruas, ne i kemi ndihmu familjes. Në Has ne kemi ndryshu gjanat në krejt shoqinë tonë.

Anita Prashtica: Cila është arritja ma e madhe?

Marta Prekpalaj: Arritje e sukses ma i madh për mu është kur kemi arritë me rritë numrin e vajzave në shkollë. Kjo është, shkollimi i vajzave të Hasit, tash në një numër të konsiderueshëm. Për mua kjo është suksezi më i madh, sepse përderisa vetë kam kalu në ato periudha të mëhershme të vështira dhe kam luftu për shkollë, atëherë ka shumë. Me individë nuk i mbaj mend, por në përgjithësi suksezi më i madh për mu mendoj është përkrahja e vajzave të reja për të vazhdu shkollimin në Has. Ky shkollim i vajzave ka ndryshu këta në një mënyrë, kanë ndryshu krejt jetën në Has. Janë ato vajza të cilat kanë mbaru shkollën e mesme të mjekësisë dhe kjo është shumë me rëndësi. Ajo gjeneratë krejt sot punojnë dhe veprojnë në të gjitha ambullantat e fshtarave të Hasit. Është ajo gjenerata e asaj shkollës që kemi hapë ne Motrat Qiriazit në Romajë si paralele e mjekësisë. Aty kanë mbaru djem e vajza bashkë, kanë mbaru atë shkollë dhe sot punojnë, veprojnë. Edhe ky është një sukses shumë i madh për mu, për njerëzit e mi, për Hasin.

Shkollimi është në nivel tashti. Çdo gjë është t'u shku për së mbari. Edhe projekti i rrugës natyrisht ka qenë edhe ky diçka e madhe, që po ashtu ka ndryshu zhvillimin këtu në Has. Edhe mbështetja edhe përkrahja e grave të Krushës të cilat për ato jam një person shumë i veçantë. Kudo që i takoj, kudo që i shoh, kur takohem me to dhe e ndjej veten mirë e për mu është kënaqësi. Të gjitha keto sukseze për mu një kënaqësi dhe nder që e kam thënë dhe du ta them, kurrë nuk mund ta ndaj a është fati jem që kam pas, fati që kam pas të punoj me dy njerëz, me dy gra të mëdhaja, motrat Safete dhe Igballë Rogova, që vërtetë për mu kanë qenë udhërrëfyeset e mia të krejt këtij aktiviteti që është ba. Kanë qenë ato të cilat më kanë përkrahë, më kanë dhënë përvojën e tyre, vullnetin për punë. Sot e kësaj dite që vazhdoj, sepse është shumë e rëndësishme si punon, por edhe është me rëndësi me kë punon. Shoqata jonë e ka përfundu misionin me shumë sukses. Kujtoj sa efektiv dhe organizim të mirë që kemi pas dhe kjo është një kënaqësi për mu, që kemi qenë një ekip shumë i mirë, shumë funksional si shoqatë, që ndoshta edhe pak rrallë ka qenë. Dihet organizimi i mirë dhe bashkëpunimi i mirë ka suksezet që i ka sot, që preken, shifën konkretisht në Has. Është kjo e gjitha.

Anita Prapashtica: A është shumë larg pritshmërisë tuaja, a është krejt ndryshe ndaj asaj që ki menu, sa saktësisht ashtu si ke mendu?

Marta Prekpalaj: Kur kemi fillu aktivitetin në vitet '90 nuk ka qenë e lehtë dhe nuk kena mujt me paramendu, e kena dit se nuk asht lehtë për me ardhë deri të çlirimi i Kosovës, bile ndoshta ne kemi mendu ma shpejt, por ka zgjatë. Zgjati diku dhjetë vite gati, një rezistencë në fillim paqësore, pak nga fundi edhe e armatosur e njerëzve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët kanë kontribu, po natyrisht edhe ne në mënyra indirekte dhe direkte i kemi ndihmu ata njerëz. Në këtë pjesën tonë, ne kemi siguru edhe barna për ushtrinë, i kemi dërgu edhe ata i kanë marrë. Mirëpo, të them të drejtën atëherë kemi mendu ma ndryshe mbas pavarësisë do të shkojnë gjërat. Do të shkojnë gjërat pak ma mirë sesa po shkojnë tash. Unë për shembull kur kam mendu se qaq gjatë do të zgjasë masi jemi çliru pavarësia edhe riorganizimi i shtetit dhe i shoqërisë, më duket se kalon një kohë bukur e gjatë. Qysh kemi mendu na, nuk është. Nuk do të thotë që nuk ka sukseze, nuk ka të mbrijmë. Mirëpo, jo ashtu siç e kemi mendu ne në vitet '90, por kanë ndryshu ndoshta gjanat edhe rrethanat jo vetëm në Kosovë, por edhe në botë dhe ndoshta nuk varet krejt prej neve. Varet prej faktorit ndërkombëtar që kemi pas këtu me organizime të ndryshme, me KFOR e UNMIK, e tash EULEX. Janë struktura që ndoshta nuk i janë qasë bash qysh duhet gjanave, qysh është dashtë rrethit dhe

mentalitetit tonë. Ne si aktiviste kohë pas kohe këto gjana i kemi luftu. Me aktivitete të ndryshme kur s'osht kon në rregull, i kemi thënë që nuk është në rregull ose kshtu duhet. Jemi mundu me ngritë zërin në shumë fusha, në shumë drejtime. Edhe sot vazhdojmë, por natyrisht është dashtë edhe me punu edhe në fuqizimin e gruas në të drejtat e saj, që hala edhe sot vazhdojmë.

Natyrisht se rezistenca e aktivisteve të grave kurrë nuk është ndalë dhe as besoj që ka me u ndalë, edhe është bile ndoshta edhe shumë më e zëshme. Jemi dëshmitarë të shumë aktiviteteve dhe organizimeve që ka ngritë shoqëria civile, në këtë rast nyjëzimi i Rrjetit të Grave ku jemi organizatat e grave që jemi të mirëorganizuara aty dhe po bëjmë rezistencë sipas momentit të kohës, po natyrisht po planifikojmë planprograme afatgjate për çështjen e gruas. Aktivistet e grave në Kosovë janë vazhdimisht të kyçura pothuajse në çdo gjë dhe në momentet kur duhet me reagu, reagojnë. Kanë organize dhe bashkëpunu, për shembull edhe me gratë në vendimmarrje. Kohë pas kohe t'u fillu edhe nga angazhimi edhe për ligjin për barazi gjinore, lufta kundër dhunës në familje, e në përgjithësi për të drejtat e grave në shoqërinë e Kosovës, e akoma kemi punë. Por, kohë pas kohe thash rezistenca vazhdon sipas kohës, momentit, qasjes për të drejtat e grave dhe fuqizimin e grave, vazhdon. Besoj se tani është një grup i madh i grave. Nuk ka më pak, po janë shumë. Jemi shumë aktiviste, jemi shumë shoqata që vazhdimisht vazhdojmë të bëjmë rezistencë paqësore për të drejtat. Kur ka pas nevojë kemi bo edhe protesta të ndryshme që janë të njohura për opinionin kohë pas kohe, në Prishtinë dhe në qendra të tjera të Kosovës, për të ngritë zërin për një padrejtësi që është ba, nga kushdo qoftë që është bo, qoftë nga qeveria, qoftë nga ndërkombëtares, qoftë nga kushdo që bën një padrejtësi ndaj grave. Ne jemi ato që e ngrejmë zërin dhe bëjmë rezistencën e duhur sipas momentit dhe kohës.

Mbas luftës, mbasi fillun të kemi televizionet tona, domethanë në Kosovë, sepse para luftës ka qenë mungesë e mediave, shumë e madhe tek ne, për fat të mirë mbas luftës fillun disa televizione me punu, qoftë qendrore apo lokale. Ishte diçka shumë e rëndësishme, opinionin filloi me pasë mundësi me marrë informatat të ndryshme t'shumta. Edhe ne si aktiviste të shoqatës Motrat Qiriazë punonim vazhdimisht me aktivitete të ndryshme dhe në planifikimet tona. Mas luftës u hap faktikisht edhe ni televizion këtu në Prizren; ishte televizion lokal, regjional mbi gjysën e Kosovës, që ishte hapur nga një person i Hasit i cili ishte kthi nga gurbeti dhe kishte ardhë kishte investu për media, se ishte televizion i Hasit në fillim pastaj TV Opinioni. Dhe unë e njoftova shoqatën dhe bisedum bashkë me grupin tonë, a t'bëjmë diçka ndonjë projekt me media, sepse mediat janë arma më e fortë për të komunikuar me publikun. Në këtë rast neve më shumë na interesonte familja dhe gratë, gjinia femërore, por natyrisht ato emisione kanë ndiku komplet familjen, nuk domethanë që shkruan veç për gruan. E kështu na fillum gjetëm përkrahje në projektin, dhe fillum emisionet ku pata fatin dhe nderin t'i udhëheqi ato emisione me vite të tëra, emisione të cilat shoqata Motrat Qiriazë i organizonte me tema të ndryshme.

Asht shumë me randsi se kur je në televizion, të sheh opinionin, n'këtë rast të sheh gruaja edhe emisionet kanë qenë të drejtpërdrejta e kjo osht shumë me rëndësi. Ato kanë pas të drejtë shprehjen, pytjen, mendimet e tyre dhe varësisht çka ato kanë kërku, unë kemi zgjedhë tema. Për shembull, përderisa asht dashtë para luftës me shku fshat më fshat e me organizu takime, e këshilla mjekësore, çfarëdo qoftë. Tani përmes medias na u dha mundësia për me komunikuar me ni numër shumë të madh të grave të regionit që drejtpërdrejtë me e dhanë mesazhin tonë, për të drejtat e tyre, për mbrojtjen e tyre, për shumë gjëra të tyre, po edhe natyrisht duke u dhanë mesazhe edukative përmes ekspertëve të fushave të ndryshme, si mjekë e psikologë e kshtu me rradhë, sipas nevojës e kërkesës. Pra për mendimin tem dhe aktivitetin tonë si shoqatë ne i kemi vlersu shumë mediat kemi realizu projekte, por edhe kemi bashkëpunu, edhe vazhdojmë t'bashkëpunojmë edhe sot natyrisht si Rrjet që jemi, si shoqatë që jemi sepse ato janë të

pazavendsushme për opinionin tonë, për shoqërinë tonë. Edhe të ne shikohen me të madhe, televizioni akoma është i shikueshëm edhe pse tash kemi zhvillimin e internetit me të madhe, ku thuajse s'ka shtëpi a fshat që s'e ka. Por prapë televizori, media e ka atë rolin e vetë sepse ajo komunikon drejtpërdrejtë me shikuesin dhe i'u jep mundësi e qasje të informacioneve të ndryshme të llojllojshme sipas nevojës.

Ma herët, tek ne ndoshta ka qenë pak si e pakuptueshme apo tabu me thanë feminizëm, apo feministe, mirëpo tash kujtoj se gjithë shoqëria jonë e ka kuptu dhe nënkuptu se çka domethanë feminizëm. Domethanë unë jam kanë, jam dhe do të jem, edhe s'ka diskutim sepse s'o kurgjo e keqe të luftosh për të drejtat e grave. Nuk ka këtu diçka të keqe me kit term, osht e drejta e çdo njeriut me zhvillu idetë e veta, mendimet e veta në çfarë fushe don me u fokusu, mirëpo kjo osht diçka shumë normale dhe nuk o diçka "jo se s'osht n'rregull." Ndoshta, thash ma heret, që osht keqkuptu po tash besoj që osht kuptu dhe jam krenare që jam, dhe nuk e mohoj e do të vazhdoj të jem, dhe me punu sa të mundem natyrisht n'këtë drejtim në të drejtat e çdo njeriu pa dallim gjinie. Por në raste konkrete femra ka pas ma shumë nevojë, dhe akoma ka nevojë për me përkrahë në shoqërinë tonë dhe shoqëritë tjera me siguri. Unë kujtoj se n'këtë drejtim kemi ba zhvillime t'mira pozitive n'Kosovë, osht ni lëvizje e fortë e grave feministe të cilat punojnë e veprojnë, po kemi edhe mashkuj që janë feminista, dhe unë kujtoj se nuk osht mo problem kjo çështje dhe besoj që Kosova osht një ndër vendet që prin për disa aktivitete n'këtë drejtim për arritjen në feminizëm. Normal që kemi pasë edhe mbështetjen e shoqeve jashtë Kosovës; janë t'shumta ato që na kanë ndihmu, na kanë përkrahë, na kanë dhanë përvojë, për të fuqizu dhe për të vazhdu këtë lëvizje më tutje.

Gjithë ajo punë që osht ba e grave, hiq s'po shkojmë ma larg, se kanë punu edhe para viteve të 90ta deri në prag të luftës, edhe gjatë luftës edhe pas luftës, nëse e shikojmë mirë, nuk është shpërbly. Nuk osht shpërbly sepse besoni, edhe gratë kanë punu shumë, nuk mujmë me i përshkru krejt ato punë se ku ka mujtë me hi sidomos n'kohën e luftës kur ka qenë kriza, aty ku kanë hi gratë nuk kanë mujt me hy burrat. Dhe tashti n'vend se shoqëria, qeveria t'a jep vendin merititor, gratë prapë po duhet me ngritë zërin vetë ato për me e marrë. Ne do të nisem me shembuj shumë konkretë. Ne kemi disa femra që kanë qenë ushtarë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, kanë qenë heronjë që kanë ra n'luftë e unë nuk di, a keni pa ju që osht ndërto ndoj përmendore, dhe shumë pak jonë shkru libra, vetëm kur kanë shkru vetë gratë për gratë. Domethanë une si ni aktiviste që jom pjesë e asaj lufte që o bo e panalshme natëditë, nuk jemi t'knaqura e nuk osht ba sa duhet, na prapë po duhet me ngritë zërin për këto gjëra me marrë iniciativa. Kemi kohëve të fundit disa... mas zgjedhjes së Presidentës ajo ka fillu me i dhanë disa mirënjohje por jo sa duhet. Për shembull rasti konkret unë edhe shumë aktiviste tona të lëvizjes sonë, ne vazhdimisht jemi shpërbly nga ndërkombëtarët, që kom marrë çmimin, Igballja e Safetja. Tash vonë, veç tash është ni mirënjohje ma n'fund që i është dhënë Motrave Qiriaz, ni mirënjohje, përndryshe se shoqata Motrat Qiriaz se nuk është vetëm Marta që ka punu në Has me aktivistet, por Motrat Qiriaz kanë punu në krejt Kosovën, është e pamundun t'i them unë të gjitha. Janë numër i madh i punëve që janë ba. Ka edhe shumë aktiviste që edhe pa shoqatë kanë punu në mënyrë individuale, grupe të ndryshme. Kujtoj se akoma nuk është qitë në dritë dhe nuk është shpërbly, dhe nuk është njohë sa duhet, nuk është pranu sa duhet.

Asht' dashtë me ba luftë për me përfaqësu gruan në Parlament, asht' ba me kuotë 30%, asht' dashtë me u ngritë me ba fushtata për fuqizimin, e dini me Rrjetin çka kemi ba përmes mediave, për vendimmarrje, për me pasë ma shumëgarë n'pozita. Nuk kemi asnjë kryetare të Komunës të Kosovës. Pse mos t'kemi kur e dimë që ka shumë gra që punojnë fuqishëm, ne kemi dy ministresha dhe një president, por për fat të keq roli i saj nuk osht aq i madh sa do të mund të ndikojë shumë gjana n'Kosovë. Kryeministria asht ma e fuqishme se Parlamenti, por tu e ditë që Kosova ka dhanë

edhe ma herët aktiviste dhe që osht Nënë Tereza⁵ me çmim Nobel botëror, mund të themi që është punu diçka pak, po jo shumë. Po gjithmonë jemi ne ato me e ngritë vetë zërin, domethanë shoqatat e grave, aktivistet tu i ngritë këto çështje nëpër vende prej nivelit lokal e deri në nivelin qendror, tu e ngritë për me u avansu, për vendimmarrje edhe për me u shpërbly, domethanë puna e saj e palodhur që asht ba në ato kohë, para luftës gjatë por edhe tash edhe pas luftës besa.

Ëndrrat

Anita Prapshtica: Cilat janë andrrat tuaja që mendoni me i realizu në të ardhmen?

Marta Prekpalaj: Kam shumë ndoshta, po do ndalem në dy. Nën një është dëshira imja ndoshta që të kem një qendër për gratë këtu tash në Has, ku do të kisha vazhdu punën ma shumë si një lloj këshilluese për të këshillu dhe për të përgatitë aktivistet e tjera të Hasit, se ashtu kam dëshirë me pas një vend. Se vërtetë ka nevojë për këtë punë, do të thotë t'i bëjmë trajnime të ndryshme që t'i përcjellin që t'mos mbetetet puna, mos ndalet puna në varësi sipas kohës. Dhe një dëshirë tjetër, si Hasjane që jam, të ndërtojmë dhe të hapim një shkollë profesionale, si tip kolegji, po të nivelit ma të mirë që asht i mundshëm ktu mrena në Has, sepse ka nevojë, domethënë, tash me reformat që po bahen në arsim. Mirëpo, kjo nuk varet prej meje, prej shoqatës. Kjo varet prej qeverisë dhe në kërkesën e kemi bo ma herët. Duhet t'mundohemi me avoku që t'kemi një shkollë të mesme të veçantë profesionale këtu në Has për femra, e cila kishte me vazhdu punën ma tutje për zhvillimin ekonomik të Hasit. Këto janë, domethanë, dy ide të miat me vazhdu punën në shoqatën tash që kam themelu Femra vizionare e shekullit 21. Por, asht fillimi dhe duhet me u angazhu, me ba një staf që t'vazhdojnë aktivitetin ma tutje. Domethanë, kjo ishte. Ka edhe t'tjera, po ktu do t'i ndalem.

Nicole Farnsworth: Cilat janë të tjerat?

Marta Prekpalaj: Po të shohim tashi. Ka edhe plane që domethënë, me vazhdu me aktivitete të ndryshme, edhe në ndonjë rajon tjetër ku s'ka shku, se kemi disa rajone ku menojmë që ma pak ka aktivitete. Këtu në regjionin e Prizrenit, janë disa pjesë, fshatra, se unë jam e përkushtume vetëm në pjesën rurale. Domethanë, një pjesë quhet Ana e Vrrinit ktu rreth Prizrenit, që pak osht prekur në atë pjesë. Po akoma ka nevojë për punë dhe angazhim edhe ana e Opojës atje. Ka fillu diçka, disa kolege po pak me i ndihmu, kështu sa t'mundem me mbërri. Faleminderit edhe juve që keni realize (buzëqeshë), që më keni përzgjedhë në këtë projekt. Ju uroj suksese! Falenderoj Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës, shumë! Igballen e juve Nicole. Të gjithëve!

Nicole Farnsworth: A bon vetëm edhe një pyetje? Kur ishte ti e vogël, cilat ishin andrrat e tua? Çka ke menu me u bo kur t'ritesh?

Marta Prekpalaj: Natyrisht, si çdo fëmijë ka andrra të ndryshme, shumë andrra. Mendon me u ba ashtu, kështu, por ajo çka unë kam ëndërru për t'u ba o mësuese dhe jam bo mësuese, dhe jam hala mësuese t'u punu. Besoj se m'asht realizu. Qëllimi im ka qenë kështu me u ba mësuese dhe jam bo. Besoj se kjo ka qenë!

Nicole Farnsworth: Edhe ti zemër? Çka po don?

⁵Referohet shoqatës Nëna Tereza jo Nënës Terezë nga Kalkuta një shqipëtare e cila ka është *beatified* në vitin 2003.

Marta Prekpalaj: Po ashtu gjatë aktiviteteve jam marrë pak edhe me aktrim. M'pëlqente aktrimi, po s'kam pas mundësi. Veç pak, si amatore, kam realizu disa drama atë kohë si nxanse, si studente.

Nicole Farnsworth: Diana [Mbesa e Martës] ti? Çka po don kur të rritesh, çka ke qef me u ba? Do me u ba edhe ti mësuese?

Diana: Nuk e di.